



# HD-T

APARAT MARRËS DIXHITAL  
TOKËSOR HD

## MANUAL PËRDORIMI



Kompleksi "Don Bosko", Kulla VII, Kati II, Tiranë Albania.

T: +355 44 800 008 F: +355 44 800 001 E: info@tring.tv

[www.tring.tv](http://www.tring.tv)

# PËRMBAJTJA

Karakteristikat .....	3	Riemërtimi i kanaleve (opsional).....	11
Aksesorët .....	3	Shtimi i kyçeve per kanalet .....	12
Masa paraprake të sigurisë .....	4	Lista e preferencave .....	12
Burimi i energjisë Energjia.....	4	Guida e programeve .....	12
Kordoni elektrik .....	4	Konfigurimi i regjistrimit .....	16
Kujdes.....	4	Konfigurimi .....	17
Informacioni i përgjithshëm mbi telekomandën.....	5	Kërkimi në modalitetin në pritje .....	18
Lidhjet .....	6	Përmirësimi i marrësit .....	18
Telekomanda .....	6	Kontrolli prindëror .....	18
Lidhja me televizorin.....	7	Klasifikimi i pjekurisë .....	18
Lidhja elektrike .....	7	Kyçi i menysë.....	18
Ndezja-Fikja.....	7	Përcaktimet e orës.....	19
Fikja automatike.....	7	Preferuar .....	19
Lidhja e antenës .....	8	Parametrat aktuale .....	19
Lidhja USB.....	8	Formati i mbështetur i videos:.....	19
E RËNDËSISHME!.....	8	Mesazhi i OSD-së .....	19
Lidhja e diskut USB.....	8	Navigimi në kanale.....	19
Regjistrimi i programeve.....	8	Paraqitja e tekstit.....	20
Sistemi i menysë kryesore.....	9	Të dhënat teknike.....	21
Zhvendosja në kohë .....	9	Telekomanda .....	21
Regjistrimi i menjëhershëm .....	10	Aftësitë dixhitale .....	21
Shikimi i programeve të regjistruara .....	10	Scart në televizor .....	21
Sistemi i menysë .....	10	Zgjidhja e problemeve .....	22
Listën e kanaleve.....	10	Informacionet e mëposhtme janë vetëm për shtetet anëtare të BE-së:.....	23
Lëvizja në të gjithë listen e kanaleve .....	11		
Fshirja e kanaleve .....	11		

## KARAKTERISTIKAT

- DVB Teletext
- Kapaciteti i kanaleve: 1000 për
- DVB informacioni i ngjarjeve për 7 ditë (EPG 7 ditë)
- TV scart (me mbështetje për RGB dhe CVBS)
- Ruajtja e kanalit të fundit të shikuar
- Kërkimi automatik për të gjitha kanalet
- Kohëmatësi mund të përdoret edhe për regjistrim
- Funkzioni i kohëmatësit i programueshëm nëpërmjet EPG
- Mbështetja e CAS e integruar: Conax CA (pa çiftim të çipit)
- Lista e preferencave
- Dalja HDMI 576p, 720p, 1080i, 1080p.
- Hyrja USB
- Opsionet e kyçit prindëror në nivele të ndryshme
- I përshtatshëm për DVB-T
- Mbështetja e LCN-së (numri logjik i kanalit).
- Shkalla e frekuencës së hyrjes: VHFIII; 174-230 MHz, gjerësia e brezit 7MHz
- UHFIV dhe UHFV; 470-862 MHz, gjerësia e brezit 8MHz
- Mbështet modulimet 16-, 64-QAM
- Opsionet e kërkimit manual dhe automatik
- VIDEO dhe OSD:
- Video: MPEG2, PAL, 4:3/16:9
- Dekoderi i videos MPEG-4 H.264/AVC MP@L3 (SD)
- Dekodimi dhe dalja e videos PAL
- Audio: MPEG-1 layer I / II, MPEG-2 layer II, MPEG-2 AAC, MPEG-4 AAC
- Dekoderi i audios në shumë formate
- Mbështetja e audios në shumë gjuhë (deri në 10)
- Blllokimi i audios dhe kontrolli i volumit
- Konsumi i energjisë së ultë (më pak se 0,5 W) (opsional)

## AKSESORËT

 <p>Pulti</p>	 <p>Bateritë 2 X AAA</p>
 <p>Kabli HDMI</p>	 <p>Udhëzuesi</p>
	 <p>Përshtatësi AC</p>

# MASA PARAPRAKE TË SIGURISË

## Burimi i energjisë Energjia

- Përdorni gjithmonë përshtatësin AC të ofruar.
- Përdorni vetëm burimin e energjisë të përcaktuar në përshtatësin AC.
- Përshtatësi i energjisë mund të nxehet gjatë funksionimit normal. Ky nuk është një defekt.
- Sigurohuni që përshtatësi të mos jetë i mbuluar gjatë funksionimit. Lini një hapësirë prej 15 cm (minimumi) rreth përshtatësit AC.
- Informacionet e klasifikimit dhe masat e sigurisë për përshtatësin AC paraqiten në përshtatës.

**PARALAJMËRIM:** Kur pajisja nuk përdoret për një kohë të gjatë, shkëputni pajisjen nga energjia elektrike.

## Kordoni elektrik

· Mos e vendosni njësinë, një mobilje, etj. mbi kordonin elektrik (kabloja e rrjetit elektrik) apo të shponi kordonin. Kapeni kordonin elektrik nga spina. Mos e hiqni spinën duke tërhequr kordonin dhe mos e prekni kurrë kordonin elektrik me duar të lagura, pasi kjo mund të shkaktojë qark të shkurtër ose goditje elektrike. Mos e bëni asnjëherë kordonin njëj, apo ta lidhni me kordonë të tjerë.

Kordonët elektrikë duhet të vendosen në mënyrë të tillë ku nuk mund të shkelen. Një kordon elektrik i dëmtuar mund të shkaktojë zjarr ose dridhje nga korrenti. Kontrolloni herë pas here kordonin elektrik. Nëse shikoni se ai është i dëmtuar, kërkoni ndihmë nga agjencia më e afërt e shërbimit.



- Ju lutemi mos e vendosni aparatin në një vend nën dritën e drejtpërdrejtë të diellit, pluhura të tepërta, goditje mekanike ose në një vend afër burimeve të nxehtësisë.
- Aparati duhet të vendoset në një bazë të qëndrueshme dhe të sigurt.
- Mos e vendosni aparatin në një sipërfaqe të butë si mbi një qilim që mund të bllokojë vrimat e ajrimit në fund.
- Vendi i zgjedhur nuk duhet të ketë lagështi të madhe. Kondensimi, që mund të krijohet në kuzhinë për shembull, mund të shkaktojë defekte ose dëmtime të pajisjes.
- Nxehtësia ose rrezatimi termik nën pajisje mund të shkaktojë gjithashtu defekte ose dëmtime të pajisjes.
- Ajri i nxehtë, që krijohet gjatë funksionimit, duhet të ventillohet nëpërmjet qarkullimit të bollshëm të ajrit. Ju lutemi mos e vendosni pajisjen në zona të mbyllura dhe mos e mbuloni.
- Kini kujdes që të siguroni një qarkullim të mirë të ajrit. Vendoseni pajisjen në një vend me ajrim

të përshtatshëm për të parandaluar krijimin e nxehtësisë në pajisje.

- Nëse brenda në pajisje bie ndonjë objekt i fortë ose lëngje, hiqeni televizorin nga priza dhe kërkoni një personel të kualifikuar ta kontrollojë para se ta përdorni përsëri.
- Pajisja nuk duhet të ekspozohet ndaj spërkatjes ose pikave të ujit dhe nuk duhet të vendosni mbi pajisje objekte të mbushura me ujë, si vazo.

## Kujdes

- Bateritë nuk duhet të ekspozohen ndaj nxehtësisë së lartë, si drita e diellit, zjarri, etj.




Lidhja me një Sistem shpërndarje televizive (televizion kabllor, etj.) nga sintonizuesi

Pajisja e lidhur me tokëzimin mbrojtës të sistemit të ndërtesës nëpërmjet lidhjes së rrjetit elektrik ose nëpërmjet aparateve të tjera me një lidhje në tokëzimin mbrojtës - dhe me një sistem televiziv të shpërndarjes duke përdorur një kablo koaksial mund të krijojnë një rrezik zjarri në disa rrethana.

Për këtë arsye lidhja me një sistem të shpërndarjes kabllorë duhet të sigurohet nëpërmjet një pajisje që garanton izolimin elektrik nën një gamë të caktuar frekuencash (izolues i galvanizuar, shikoni EN 60728-11).

# INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM MBI TELEKOMANDËN




# LIDHJET

## PAMJA E PËRPARME



## PAMJA E PASME



1. FOLEJA E KABLOS ELEKTRIKE: Foleja DC 12V përdoret për lidhjen e përshtatësit të ofruar
2. HYRJA E ANTENËS: Vendi i hyrjes së antenës
3. DALJA E ANTENËS: Për të pare kanalet analoge në televizor
4. DALJA HDMI: Lidhja e daljes HDMI (në televizor)
5. AUDIO OPTIKE: Dalja e audios dixhitale optike
6. SCART E TELEVIZORIT: Lidhja SCART e televizorit


## PËRDORNI VETËM PËRSHTATËSIN E OFRUAR

## TELEKOMANDA

Në fillim hapni kapakun e baterive në pjesën e poshtme të telekomandës. Futni të dyja bateritë 1,5 volt (R03/AAA) duke iu referuar simboleve të shtypura (+/-) në kutinë e baterive dhe rivendosni përsëri kapakun. Kur përdorni telekomandën, drejtojeni nga pjesa e përparme e marrësit. Nuk telekomanda nuk punon ose funksioni i zgjedhur nuk funksionon, bateritë ka mundësi të jenë të shkarkuara dhe duhet të zëvendësohen sa më shpejt të jetë e mundur. Ju lutemi përdorni vetëm bateri të siguruar kundër rrjedhjeve. Është më mirë që t'i hiqni bateritë nga telekomanda nëse nuk do ta përdorni telekomandën për një kohë të gjatë.



## LIDHJA ME TELEVIZORIN



Lidhni dekoderin me një kablo scart me anë të bashkuesit scart të televizorit në panelin prapa të bashkuesit scart të televizorit. Dekoderi ka dalje RGB ose CVBS. Nëse dëshironi që të merrni figurën nëpërmjet bashkuesit scart dhe bashkuesi scart i televizorit ka një hyrje RGB, atëherë mund ta kaloni dekoderin tuaj dixhital në modalitetin RGB duke e kthyer menyën e daljes së televizorit në modalitetin RGB në menyën e konfigurimit. Në këtë mënyrë do të arrini të merrni një cilësi të lartë nga aparati dixhital i dekoderit.

## LIDHJA ELEKTRIKE

**E RËNDËSISHME:** Dekoderi është i projektuar të funksionojë në 12V DC. Për këtë arsye përdoret një përshtatës që jep një tension 12V. Lidhni këtë adaptor me një sistem që furnizon me 220-240 V, AC50 Hz.

Pas heqjes së paketimit, lëreni dekoderin që të arrijë temperaturën e ambientit në dhomë para se ta lidhni me rrjetin elektrik.


## NDEZJA-FIKJA

Sigurohuni që të lidhni të gjitha kabllot e nevojshme. Pas lidhjes së kordonit elektrik të dekoderit me rrjetin elektrik, në panelin e përparmë do të shikoni një dritë (modaliteti në pritje). Kur dekoderi të ndizet për herë të parë, ju lutemi prisni pak para se ta aktivizoni marrësin, meqenëse aktivizimi i softuerit do të kërkojë pak kohë. Më pas mund të ndizni aparatin e dekoderit dixhital duke shtypur butonin në pritje në telekomandë. Ju do të shikoni se drita në panelin e përparmë do të ndryshojë (Modaliteti i ndezjes).

### Fikja automatike

Aparati do të kalojë automatikisht nga modaliteti aktiv në modalitetin në gatishmëri, pas më pak se tre orë në modalitetin aktiv në vijim të ndërveprimit të fundit të përdoruesit dhe/ose një ndryshimi të kanalit me një mesazh sinjalizues dy minuta para kalimit në modalitetin në gatishmëri. Fikja automatike do të vendoset si e paracaktuar dhe përdoruesi do të ketë mundësinë ta ndryshojë Fikjen automatike si aktive ose joaktive në meny.

# LIDHJA E ANTENËS



## LIDHJA USB

- Ju mund të lidhni një njësi disku të ngurtë me USB ose kartë memorie USB me aparatit duke shfrytëzuar hyrjen USB të televizorit. Kjo karakteristikë ju mundëson të lexoni skedarët në një njësi USB ose që të regjistroni programe.
- Njësitë e jashtme të diskut të ngurtë 2,5 dhe 3,5 inç (hdd me burim të jashtëm energjie) janë të përshtatshëm.
- Për të regjistruar një program, duhet të lidhni një disk USB me aparatit tuaj kur ai të jetë i fikur. Më pas duhet të ndizni aparatit për të aktivizuar funksionin e regjistrimit. Në rast të kundërt, funksioni i regjistrimit nuk do të jetë i disponueshëm.

### E RËNDËSISHME!

- Ju mund të krijoni një kopje rezervë të skedarëve tuaj para se të kryeni një lidhje me aparatit, në mënyrë që të shmangni ndonjë humbje të mundshme të të dhënave. Kini parasysh që prodhuesi nuk do të jetë përgjegjës për asnjë dëmim të skedarëve apo humbje të të dhënave.
- Lloje të caktuara të pajisjeve USB (p.sh. lexuesit MP3) ose njësitë e diskut të ngurtë USB/kartat e kujtesës mund të mos përshtaten me këtë pajisje.

**E RËNDËSISHME:** Pajisja mbështet vetëm formatimin e diskut FAT32. Formatimi NTFS nuk mbështetet. Nëse lidhni një disk USB me format NTFS, aparatit do t'ju kërkojë të formatojë përmbytjen e tij. Shikoni në paragrafin "Formato diskun" në faqet e mëposhtme për më shumë informacione mbi formatimin e diskut.

Kini parasysh që të gjitha të dhënat në diskun USB do të humbasin dhe më pas formati i diskut do të konvertohet në FAT32 në një rast të tillë.

### Lidhja e diskut USB

- Futni pajisjen tuaj USB në hyrjen USB të aparatit. Shënim: Lidhni ose shkëputeni diskun USB kur aparatit është i fikur.

Shënim: Nëse do të lidhni një njësi të diskut të ngurtë USB me një aparat, kabloja dhe lidhjes USB mes diskut dhe aparatit duhet të ketë një logo USB dhe duhet të jetë sa më e shkurtër.

Shënim: Kur formatoni një disk USB që ka 1 TB (Terabajt) ose më shumë, mund të vini re probleme gjatë procesit të formatimit. Në një rast të tillë, ju duhet të formatoni diskun me kompjuterin tuaj personal dhe lloji i diskut të formatuar duhet të jetë FAT32.

### KUJDESI!

- Lidhja dhe heqja e shpejtë e pajisjeve USB është një veprim shumë i rrezikshëm. Lidhja dhe heqja e përsëritur mund të shkaktojë dëmtime fizike të lexuesit USB dhe të vetë pajisjes USB.
- Mos e hiqni modulën USB kur një skedar është duke u lexuar ose në regjistrim.

### Regjistrimi i programeve

**E RËNDËSISHME:** Kur përdorni një njësi disku të re USB, rekomandohet që në fillim të formatoni diskun duke përdorur opsionin e pajisjes "Formato diskun".

- Për të përdorur funksionin e regjistrimit, ju duhet të lidhni një disk USB ose njësi disku të jashtëm




me aparatin dhe disku USB në lidhje duhet të ketë të paktën 1GB kapacitet dhe përputhje me shpejtësinë 2.0. Nëse pajisja USB në lidhje nuk e mbështet shpejtësinë 2.0, do të shfaqet një mesazh gabimi.

- Një orë regjistrim i ruajtur zë afërsisht 2 GB hapësirë.
- Për më shumë informacione mbi programet e regjistrimit shikoni në paragrafin "Regjistrimet menjëhershme", "Guida e programeve elektronike", "Biblioteka e regjistrimeve" ose "Kohëmatësit e regjistrimit" në pjesët e mëposhtme.


Programet e regjistruara ruhen në drejtorinë e mëposhtme të diskut USB në lidhje: \DVR\RECS. Për çdo regjistrim krijohet një skedar .idx. Ky skedar përfshin informacione si transmetuesi, programi dhe koha e regjistrimit.

## SISTEMI I MENYSË KRYESORE

Kur aparati hapet nga modaliteti në pritje dhe nëse nuk ka asnjë kanal të ruajtur në bazën e të dhënave, në ekran do të shfaqet dritarja e Menyse së instalimit për herë të parë. Në dritaren e pare do të kërkohet gjuha e menyse.



Duke shtypur butonat "▲" ose "▼", evidentoni gjuhën që dëshironi të vendosni dhe shtypni butonin OK. Pas kësaj në ekran do të shfaqet OSD-ja "Instalimi për herë të parë". Në dritaren tjetër duhet të caktoni llojin e televizorit, shtetin, formatin e ekranit dhe rezolucionin e figures në HD.



Me anë të butonave "◀/▶" në telekomandë, mund të zgjidhni: 576p, 720p, 1080p dhe 1080i. Kontrolloni rezolucionet e mbështetura nga televizori juaj dhe zgjidhni rezolucionin më të përshtatshëm nga kjo meny.

Pasi të përfundoni rregullimin e parametrave, aparati do të gjejë dhe do të sintonizohet automatikisht te kanalet, dhe do t'i ruajë. Ju mund të shtypni butonin "MENU" në çdo moment gjatë procesit.

## ZHVENDOSJA NË KOHË

**E RËNDËSISHME:** Për të regjistruar një program, duhet të lidhni një disk memorie USB me aparatin tuaj kur aparati të jetë i fikur. Më pas duhet të ndizni aparatin për të aktivizuar funksionin e regjistrimit. Në rast të kundërt, funksioni i regjistrimit nuk do të jetë i disponueshëm.

- Kur shikoni një program në transmetim, shtypni butonin (PAUZË) për të kaluar në modalitetin e zhvendosjes në kohë.
- Në modalitetin e zhvendosjes në kohë, programi ndërpritet dhe regjistrohet njëkohësisht në diskun e lidhur USB (\*). Shtypni përsëri butonin (PAUZË) për të parë programin e ndërprerë nga momenti i ndalimit.
- Ky rilexim kryhet me shpejtësi rileximi x1. Ju do të shikoni diferencën e zhvendosjes në kohë mes programit të zhvendosur dhe atij real në shiritin e informacionit.
- Përdorni butonat (Rikthe/Përpara) përtë ecur para ose prapa gjatë rileximit në zhvendosjen në kohë. Kur të arrini zhvendosjen në kohë, modaliteti i zhvendosjes në kohë do të ndërpritet dhe ju do të ktheheni në transmetimin normal.
- Shtypni butonin (NDALO) për të mbyllur modalitetin e zhvendosjes në kohë. (\*) Kohëzgjatja e regjistrimit të njëkohshëm të zhvendosjes në kohë varet nga madhësia e skedarit në memorien USB dhe Zhvendosja maksimale në kohë e përcaktuar në menyën e Konfigurimit të regjistrimeve. Shikoni në paragrafin "Regjistrimet" për më

shumë informacione mbi caktimin e Zhvendosjes maksimale në kohë.


Shënim: Kalimi te një transmetim ose burim tjetër dhe menyja kryesore nuk janë të disponueshme gjatë regjistrimit

## REGJISTRIMI I MENJËHERSHËM

- Shtypni butonin ● **(REGJISTRO)** për të filluar menjëherë regjistrimin kur jeni duke shikuar një program. Në ekran do të shfaqet dritarja OSD si më poshtë.\* Dritarja OSD e regjistrimit do të shfaqet më pas për një kohë të shkurtër dhe programi aktual do të regjistrohet.
- Ju mund të shtypni përsëri butonin ● **(REGJISTRO)** në pult për të regjistruar programin tjetër në EPG. Në këtë rast OSD do të shfaqë ngjarjet e programuara për regjistrim. Shtypni butonin ■ **(NDALO)** për të anuluar regjistrimin e menjëhershëm. OSD e mëposhtme do të shfaqet:

Zgjidhni Po duke përdorur butonat “◀” ose “▶” / **OK** për të anuluar regjistrimin e menjëhershëm.

Shënim: Kalimi te një transmetim tjetër dhe shfaqja e Shfletuesit të medias nuk janë të disponueshme gjatë regjistrimit. Gjatë regjistrimit mund të shikoni vetëm transmetimet që janë në të njëjtin multipleks.



## SHIKIMI I PROGRAMEVE TË REGJISTRUARA

Në menyën kryesore nënvizoni Bibliotekën e regjistrimeve duke përdorur butonat “▲” / “▼” dhe shtypni butonin **OK** për ta hapur.

E RËNDËSISHME: Për të parë bibliotekën e regjistrimeve, në fillim duhet të lidhni një disk USB me aparatit tuaj kur ai të jetë i fikur. Më pas duhet të ndizni aparatit për të aktivizuar funksionin e regjistrimit. Në rast të kundërt, funksioni i regjistrimit nuk do të jetë i disponueshëm.



Zgjidhni një artikull të regjistruar nga lista (nëse është regjistruar më parë) duke përdorur butonin “▼” ose “▲”.

**OK:** Fillon regjistrimin nga fillimi.

► **(Vazhdo):** Rifillo rileximin.

Shënim: Menyja kryesore dhe elementet e menysë nuk do të jenë të disponueshëm gjatë rileximit.

## Sistemi i menysë

Shtypni butonin MENYJA për të hyrë në menyën kryesore. Elementet që mund të përdorni në menyën kryesore janë:



1. Lista e kanaleve
2. Organizim
3. Arkiva e regjistrimeve
4. Shfletuesi i medias
5. Regjistrimet e planifikuara
6. Hyrja e kushtëzuar


## Lista e kanaleve

Në këtë meny mund të kryhen veprimet e mëposhtme:

1. Navigimi në të gjithë listen e kanaleve
2. Lëvizja e kanaleve
3. Fshirja e kanaleve të padëshiruara
4. Riemërtimi i kanaleve
5. Shtimi i kyçeve për kanalet
6. Lista e preferencave




Shënim: "Fshirja e kanaleve, riemërtimi i kanaleve, shtimi i kyçit për kanalet" nuk janë të mbështetura në Hungari në rast se nuk është aktiv modaliteti i preferencave në listen e kanaleve.

Shënim: Shtypni butonin  për të aktivizuar funksionin Filter Channel List dhe përdorni butonat "▼" ose "▲" për të vendosur opsionin e dëshiruar. Vetëm kanalet e filtruara do të jenë të disponueshme dhe mund të shikohen nëse ju nuk keni çaktivizuar mënyrën filter.

### Lëvizja në të gjithë listen e kanaleve

Në tabelën e kanaleve, butonat "▲" / "▼" shërbejnë për të lëvizur fokusin nga kanali i mëparshëm ose tjetër, butoni i KUQ / JESHIL për faqen lart ose faqen poshtë. Për të parë një kanal specifik, nënvizojeni me anë të butonit të KUQ / JESHIL dhe më pas shtypni OK. Më pas emri dhe numri i kanalit të zgjedhur do të shfaqen në fund të ekranit të para afshimit. Nëse kanali i zgjedhur është i mbrojtur me fjalëkalim, do të shfaqet një meny kërcyese. Nëse futni kodin e saktë, mund të shikoni kanalën e zgjedhur. Po ashtu mund të zgjidhni një kanal tjetër duke naviguar me anë të butonave "▲" / "▼". Shiriti i lëvizjes në mes të ekranit shfaq pozicione relative të kanaleve aktualisht të dukshme në lidhje me të gjithë listën. Kur shtypni butonin i (informacion) në telekomandë, do të shfaqet elementi i mëposhtëm. Në këtë element mund të shikoni shpjegimet e opsioneve në Listen e kanaleve.



Zhvendosja e kanaleve në listen e kanaleve Ndryshimi i renditjes së listës mund të bëhet duke i lëvizur programet një nga një në pozicione të reja. Për të bërë këtë, nënvizoni butonin "Lëviz" duke shtypur butonin "◀" / "▶". Me anë të butonave "▲" / "▼", zgjidhni programin që duhet të lëvizni dhe shtypni butonin OK. Më pas fusni kanalën e ri të programit që dëshironi të lëvizni dhe programi do të caktohet siç e keni futur. Në disa vende, renditja e kanaleve rregullohet automatikisht nga transmetuesi. Kjo renditje quhet numri logjik i kanalit (LCN). Nëse shteti i zgjedhur ofron mbështetje për LCN, kanalet do të numërohen një nga një, duke filluar nga numri 1. Ju nuk mund të lëvizni asnjë program te një pozicion pas programit të fundit të ruajtur. Nëse provoni këtë gjë, të dy programet do të ndryshojnë vendet e tyre. Nëse mbështetja për LCN nuk është e disponueshme, ju mund t'i lëvizni kanalet në 1-999. Nëse dëshironi të lëvizni ose fshini kanalet, shërbimi LCN do të çaktivizohet.

### Fshirja e kanaleve

Për të fshirë një kanal, nënvizojeni me butonin "▲" / "▼" dhe më pas nënvizoni butonin "Fshi" me "◀" / "▶" dhe shtypni OK. Do të shfaqet një mesazh për të konfirmuar vendimin tuaj. Nëse dëshironi që ta fshini, shtypni edhe një herë OK dhe kanali do të fshihet, në rast të kundërt veprimi do të anulohet nëse zgjidhni "JO".

### Riemërtimi i kanaleve (opsional)

Për të riemërtuar një kanal specifik, nënvizojeni dhe zgjidhni butonin "Modifiko emrin" dhe shtypni butonin OK. Duke ndjekur procedurën e mëparshme, emri do të shfaqet në mes të ekranit me karakterin e pare të theksuar. Tani "◀" / "▶" ju çon te karakteri i mëparshëm/tjetër. "▲" / "▼" ndryshon karakterin aktual. Shtypja e butonave numerikë '0...0' zëvendëson karakterin e nënvizuar me karakteret e shtypura mbi buton një nga një, siçshtypet butoni. Shtypja e MENYSË anulon modifikimin dhe OK man emrin e ri.

## Shtimi i kyçeve per kanalet

Blokkimi i kanaleve ofron një hyrje të mbrojtur me fjalëkalim për kanalet e zgjedhur nga prindërit. Për të kyçur një kanal ju duhet të dini fjalëkalimin e Kyçit prindëror (të caktuar si 0000 në fabrikë dhe mund të ndryshohet vetëm nga Menyja e konfigurimit), më pas theksoni kanalën që do të kyçni dhe zgjidhni butonin "Kyç". Kur të shtypni OK, do të shfaqet një dritare dialoguese e fjalëkalimit. Fusni kodin e Kyçit prindëror, shtypni OK dhe ikona e Kyçit do të shfaqet para kanalit të zgjedhur. Përsëritni në njëjtin veprim për të anuluar kyçin.

## Lista e preferencave



Lista e preferencave siguron një mënyrë të thjeshtë për të grupuar programet në një mënyrë të personalizuar. Në listen e kanaleve, programet mund të shtohen ose të hiqen nga një listë e preferencave. Për të shtuar ose hequr një program nga një listë preferencash, theksoni butonin "Preferenca" me anë të butonave "◀"/"▶" dhe do të shfaqet nënmenyja e preferencave. Me pas zgjidhni programin që do të shtoni / hiqni nga lista e preferencave duke përdorur "▼"/"▲", zgjidhni emrin e listës së preferencave (në cilin program do të shtohet) duke përdorur butonat "◀"/"▶" dhe më pas shtypni OK. Ikona e programit të preferuar do të shfaqet ose do të hiqet në/nga shiriti i programit të zgjedhur. Shtypja e butonit Meny ruan të gjitha përcaktimet tuaja.

Për të shkuar te lista e preferencave, shtypni butonin FAV në telekomandë për të aktivizuar modalitetin e preferencave. Ju mund të lëvizni nëpër kanalet në listen e preferencave me anë të butonave P+/P-. Për të dale nga modaliteti i preferencave, shtypni përsëri butonin FAV.

## Guida e programeve

Guida elektronike e programeve shfaqet në ekran kur shtypni butonin EPG. Mund të merrni informacionet e programeve të kanalit për gjithë javën nëpërmjet 7-DAY-EPG. Do të shfaqen të gjitha programet e kanaleve.



Programi aktual është i theksuar dhe nëse shtypni butonin e informacionit, do të shikoni një informacion të shkurtër mbi programet e kanalit, si emri, përshkrimi i shkurtër/i zgjeruar i ngjarjes, ora e nisjes dhe e mbarimit. Duke shtypur përsëri butonat "◀"/"▶", mund të ndryshoni shkallën e kohës. Nëse nuk ka informacione të ngjarjes, do të shfaqen vetëm emrat dhe datat e programit. Shiriti i informacionit që tregon të gjitha komandat e disponueshme të renditura më poshtë mund të hapet me anë të butonit "MENU".



**Butoni Blu:** Hap menyën 'Kërkimi i kanaleve'.

**Butoni OK:** Shfaq dritaren OSD 'Opsionet e ngjarjes' ku mund të zgjidhni një kanal dhe ta regjistroni.

**INFO:**Jep informacione mbi programin e zgjedhur.

**Butonat numerikë:** Shkojnë të kanali i preferuar.

**Butoni MENYJA:** Shfaq dritaren OSD 'INFO'. Opsionet në shirit shfaqen më poshtë:

**Butoni TITRAT:** Hap menyën 'Zgjidh zhanrin'. Këtu mund të zgjidhni programet sipas kontekstit (edukim, drama, sporte, etj.)

◀◀ / ▶▶: Faqja majtas / Faqja djathtas (shfaq orën e programeve në rend kronologjik)

**Butoni TXT:** Aktivizon dritaren "Kërkimi i guides".

▶(TANI): Kalon te transmetimi aktual.

**Regjistri:** Regjistron programin e zgjedhur.

**Butoni i verdhë (zmadhimi):** Ngushton kutitë e informacionit. Në këtë mënyrë mund të shikoni të gjitha programet e kanalit të zgjedhur për atë ditë.

**Butoni PR/CH-:** Shfaq programet e ditës së mëparshme.

**Butoni PR/CH+:** Shfaq programet e ditës tjetër.

### Opsionet e ngjarjes

Në menynë EPG, shtypni butonin **OK** për të hyrë në menynë "Opsionet e ngjarjes".

### Zgjidh kanalim

Në menynë EPG, me këtë opsion ju mund të kaloni te kanali i dëshiruar.

### Regjistro/Anullo regjistrimin

**E RËNDËSISHME:** Për të regjistruar një program, duhet të lidhni një disk USB me aparatit tuaj kur ai të jetë i fikur. Më pas duhet të ndizni aparatit për të aktivizuar funksionin e regjistrimit. Në rast të kundërt, funksioni i regjistrimit nuk do të jetë i disponueshëm.

Pasi të keni zgjedhur një program në menynë EPG, shtypni butonin **OK** dhe do të shfaqet ekran i Opsioneve. Zgjidhni opsionin "Regjistro" dhe shtypni butonin **OK**. Pas këtij veprimi, regjistrimi do të caktohet te programi i zgjedhur.

Për të anuluar një regjistrim të përcaktuar, nënvizoni programin dhe shtypni butonin **OK**, dhe zgjidhni opsionin "Anullo regjistrimin". Regjistrimi do të anulohet.

Shënim: Ju nuk mund të kaloni te një kanal ose burim tjetër kur ka një regjistrim të aktivizuar në kanalim aktual.

### Cakto rikujtesën/Anullo rikujtesën

Pasi të keni zgjedhur një program në menynë EPG, shtypni butonin **OK** dhe do të shfaqet ekran i Opsioneve. Zgjidhni opsionin "Cakto rikujtesën" dhe shtypni butonin **OK**. Ju mund të caktoni një kohëmatës për programet e ardhshme.

Për të anuluar një kohëmatës të caktuar, nënvizoni programin dhe shtypni butonin **OK**. Më pas zgjidhni opsionin "Anullo kohëmatësin".

Kohëmatësi do të anulohet. Shënim: Nuk mund të regjistroni ose caktoni kohëmatës për dy ose më shumë ngjarje të veçanta në të njëjtin interval kohor.

### KOHËMATËSIT:

**E RËNDËSISHME:** Për të parë kohëmatësit ose për të regjistruar programet, duhet të lidhni së pari një disk USB me aparatit tuaj kur aparatit të jetë i fikur. Më pas duhet të ndizni aparatit për të aktivizuar funksionin e regjistrimit. Në rast të kundërt, funksioni


i regjistrimit nuk do të jetë i disponueshëm.

Aktivizoni këtë nga "Planifiko regjistrimet" në menynë kryesore. Për të shtuar një kohëmatës, shtypni butonin e **Verdhë** në telekomandë.

Më pas do të shfaqet dritarja "Shto kohëmatës".



Ju mund të shtoni, hiqni dhe shfaqni kohëmatësit e mëparshëm të caktuar në këtë ekran: Do të shikoni opsionet më poshtë:



**Kanali:** "Zgjedh një kanal.

**Lloji i regjistrimit:** Përcakto llojin e regjistrimit.

**Data:** Data e fillimit regjistrohet me butonat Majtas/Djathtas ose butonat numerikë.

**Fillo:** Ora e fillimit regjistrohet me butonat Majtas/Djathtas ose butonat numerikë.

**Mbyllja:** Ora e mbylljes regjistrohet me butonat Majtas/Djathtas ose butonat numerikë.

**Kohëzgjatja:** Shfaq kohëzgjatjen mes Orës së fillimit dhe mbarimit.

**Përsërit:** Përsërit kohëmatësin një herë, çdo ditë ose çdo javë. Mund të zgjidhni intervalet me anë të butonave "◀"/"▶".

**Rileximi:** Këto parametra përcaktojnë kontrollin e rileximit. Ato mund të caktohen si "I lejuar", "I ndaluar" ose si "Përdor parametrat prindërorë". Ju mund t'ju kërkohet të futni kodin tuaj PIN.

**Ndrysho/Fshi:** Lejon ose ndalon modifikimet për përdoruesit e tjerë.

Rregullimet e bëra mund t'i ruani duke shtypur tastin **JESHIL** ose mund ta anuloni procesin duke shtypur butonin e **KUQ**. Listën mund ta modifikoni me butonin **JESHIL** ose mund ta fshini me butonin e



## KUQ.

Rreshti jeshil në fund të ekranit shfaq hapësirën e disponueshme të diskut. Rreshti i kuq tregon hapësirën e përdorur të diskut.

## Modifikimi i një kohëmatësi

Zgjidhni një kohëmatës në menyën e Kohëmatësve duke shtypur butonat "▼"/"▲". Shtypni butonin **OK** në telekomandë dhe në ekran do të shfaqet dritarja OSD - Modifiko kohëmatësin

Ju mund të caktoni preferencat e dëshiruara dhe kur të përfundoni, mund të shtypni butonin Jeshil për të ruajtur parametrat.

## Fshirja e një kohëmatësi

Zgjidhni një kohëmatës në menyën e Kohëmatësve duke shtypur butonat "▼"/"▲". Shtypni butonin **BLU** për ta fshirë. Mund t'ju kërkohet të futni kodin PIN. Pasi ta vendosni, do të shfaqet një ekran konfirmimi: "Fshi këtë kohëmatës?" Zgjidhni Po për të fshirë kohëmatësin ose zgjidhni Jo për të anuluar.

## BIBLIOTEKA E REGJISTRIMEVE

**E RËNDËSISHME:** Per të parë bibliotekën e regjistrimeve, në fillim duhet të lidhni një disk USB me aparatin tuaj kur ai të jetë i fikur. Më pas duhet të ndizni aparatin për të aktivizuar funksionin e regjistrimit. Në rast të kundërt, funksioni i regjistrimit nuk do të jetë i disponueshëm.

Për të parë listën e regjistrimeve, shtypni butonin **MENU** për të shfaqur menyën kryesore dhe përdorni butonat "◀"/"▶" për të nënvizuar.

Biblioteka e regjistrimeve dhe shtypni butonin **OK**. Më pas do të shfaqet Biblioteka e regjistrimeve me regjistrimet e disponueshme.



Të gjitha regjistrimet ruhen në një listë në bibliotekën e regjistrimeve.

**Butoni BLU (Fshi):** Fshin regjistrimin e zgjedhur.

**Butoni OK:** Hap 'Opsionet e leximit' (Lexo nga nisja, Vazhdo, Lexo nga pika e aktivizimit, Menaxho kapitujt)

**Modifiko:** Bën ndryshime në regjistrimin e zgjedhur.

▶ **(Vazhdo):** Rifilloi rileximin.

**Butoni TXT (Rendit):** Mund ti renditni regjistrimet

sipas emrit, gjatësisë, etj.

**Butoni INFO (detajet):** Shfaq programet e shkurtura dhe të zgjeruara në detaje. Shënim: Menyja kryesore dhe elementet e menysë nuk do të jenë të disponueshëm gjatë rileximit.

**HYRJA E KUSHTËZUAR (opsionale):** Moduli i ndërfaqes së përgjithshme mund të përdoret vetëm për funksionimin e shërbimit.

## PARAMETRAT

Rregullimet në këtë meny paraqiten si më poshtë:



## Instalimi

Menyja e instalimit ka si qëllim kryesor t'ju ndihmojë të krijoni një Tabelë të kanaleve në marrësin tuaj në mënyrë sa më efektive. Këto ndodhen në Meny:

1. Skanimi automatik i kanaleve
2. Kërkimi manual
3. Formato njësinë e diskut
4. Instalimi per here te pare

## Kërkimi automatik



Fillon duke zgjedhur **OK** në menyën e dritares së kërkimit automatik. Do të krijohen të gjitha elementet dhe do të krijohet automatikisht një tabelë e kanaleve. Çdo kanal ekzistues do të fshihet. Të gjitha kanalet e gjetura do të renditen sipas numrit të kanalit dhe do të ruhen.

Shënim: Kur aparati është në modalitetin e

gatishmërisë, do të kërkohen dhe do të ruhen transmetimet e disponueshme. Nëse aparati përcakton një transmetim që mungon, do të shfaqet një dritare e menysë e cila ju pyet nëse dëshironi të kryeni këto ndryshime. Nëse gjatë modalitetit në gatishmëri gjenden kanale të reja, aparati do t'i shtojë të gjitha kanalet e reja automatikisht te lista e programeve (opsionale).

### Kërkimi manual

Kërkimi manual mund të kryhet në 2 mënyra të ndryshme.

1. Kërkimi i kanaleve:


Mund të kërkoni vetëm kanalet. Futni numrin duke përdorur butonat numerikë dhe shtypni OK për të filluar.

2. Kërkimi i frekuencës:

Kanalet mund të kërkohen sipas frekuencave të tyre. Futni numrin me butonat numerikë dhe shtypni OK për të filluar.

### Instalimi për here të pare

Ky element mund të përdoret për të ngarkuar përcaktimet e paracaktuara, që janë ngarkuar në aparatin marrës në fabrikë. Për të instaluar përcaktimet e fabrikës, nënvizoni menyën "Instalimi për herë të parë" dhe shtypni butonin OK, më pas do t'ju kërkohet të konfirmoni fshirjen e të gjitha kanaleve dhe përcaktimeve.



Nëse zgjidhni Po dhe shtypni butonin OK, e gjithë tabela e kanaleve do të fshihet. Pasi të ngarkohen përcaktimet e fabrikës, do të fillojë 'Instalimi për herë të parë'.

### Formato njësinë e diskut

Kur zgjidhni këtë, do t'ju kërkohet të futni kodin PIN. Më pas do të shfaqet një meny kërcyese. Nëse zgjidhni "Po", të gjitha regjistrimet dhe kohëmatësit do të fshihen.

### Shfletuesi i medias

Ju mund të lexoni skedarë MP3, JPEG ose AVI nga një pajisje USB si kartë memorie, lexues i shumëfishtë i kartave, etj. Kur lidhni një pajisje USB, marrësi e njeh atë automatikisht dhe shfaq në ekran ikonat njësisë USB 1, njësisë USB 2, etj. Nënvizoni pajisjen që dëshironi të zgjidhni me butonat e drejtimit dhe shtypni butonin OK.

**Shënim:** Disa pajisje per USB mund të mos mbështeten.


**Shënim:** Nëse pajisja USB nuk njihet pas fikjes/

ndezjes ose Instalimit për herë të parë, hiqni pajisjen USB dhe fikni/ndizni aparatin. Më pas fusni përsëri pajisjen USB.

Leximi i skedarëve MP3:

**Butoni OK (Lexo këtë):** Lexon skedarin e zgjedhur

**Butoni INFO (Përsërit/Përziej):** Lexon skedarin e zgjedhur në vazhdim.



**Lexo+përsërit:** Lexon të gjithë skedarët media duke filluar vazhdimisht me skedarin e zgjedhur.

**Lexo+përsërit+përziej:** Lexon skedarët në mënyrë rastësore. Nëse aktivizohet modaliteti i përzjerjes, funksioni "i mëparshëm/tjetër" do t'ju çojë gjithashtu te këngë të zgjedhura rastësisht.

**Lexo:** Lexon të gjithë skedarët media në dosje duke filluar me skedarin e zgjedhur.

**Ndërpit/vazhdo:** Ndërpret dhe rifillon leximin e skedarit

**Ndalo:** Ndalon leximin e skedarit.

**I mëparshëm/tjetër:** Kalon në skedarin e mëparshëm ose tjetër për të vazhduar leximin.

**Butoni Blu:** Butoni i shkurtores. Ndërron meny të mediave të tjera (Fotografi, Video, Muzikë)

**Butoni jeshil:** Ndhomon në shfletimin e skedarëve me shpejtësi lart.

**Butoni i kuq:** Ndhomon në shfletimin e skedarëve me shpejtësi poshtë.

**Audio:** Rendit skedarët sipas titullit, albumit dhe artistit.

**Shikimi i skedarëve JPEG**

**Kërc:** Kalon te skedari i zgjedhur duke përdorur butonat numerikë.

**OK:** Shikon foton e zgjedhur në ekran të plotë.


**Lexo / Shfaqje diapozitivësh:** Hap një shfaqje diapozitivash me të gjitha fotot në dosje.


**Pauzë:** Ndërpret shfaqjen.


**I mëparshëm/tjetër:** Kalon në skedarin e mëparshëm ose tjetër të shfaqjes së diapozitivëve.

**DIL :** Prapa te lista e skedarëve.

**Vazhdo :** Vazhdon me shfaqjen.



**Përziej:** Shfaq skedarët në rend të rastësishëm dhe vazhdon në dosjen aktuale dhe ikona  shfaq ikonën e nënvizuar. Nëse gjatë një shfaqje me diapozitivë aktivizohet modaliteti "përziej", fotot e tjera do të zgjidhen rastësisht. (Nëse funksioni "përsërit" nuk është aktiv, shfaqja me diapozitivë do të përfundojë në fund. Nëse aktivizohet funksioni "përsërit", pasi mbaron shfaqja me diapozitivë, ajo do të rifillojë vazhdimisht).

**Përsërit:** Shfaqja e diapozitivëve vazhdon e përsëritet dhe ikona  kthen ikonën e nënvizuar.

**Info:** Aktivizon shiritin e operacioneve.

**Butoni jeshil:** Ndihmon në shfletimin e skedarëve me shpejtësi lart.

**Butoni i kuq:** Ndihmon në shfletimin e skedarëve me shpejtësi poshtë.

**Butoni i verdhë:** Cakton intervalin e kohës mes skedarëve gjatë rrëshqitjes. (Nga 5s deri në 30s)

**Audio:** Rendit skedarët sipas dates.

**Rileximi i videos (opsional)**



▶: Lexon/ndërpret skedarin.

■: Ndalon rileximin.

Kërce: Lexon skedarin nga momenti që keni caktuar. Përdorni butonat "◀"/"▶" për të caktuar kohën që dëshironi.

**Audio:** Zgjedh opsionet e titrave ose audios.

**TITRAT:** Aktivizon ose çaktivizon titrat.

**Rikthe / përpara (◀◀ / ▶▶):** Ecën prapa / Ecën përpara.

Shtypni butonin **MENU/PRAPA** për t'u kthyer te menya e mëparshme.

## Konfigurimi i regjistrimit

Zgjidhni elementin e Konfigurimit të Regjistrimeve në menyën e Parametrave për të konfiguruar parametrat e regjistrimit. Menya e mëposhtme do të shfaqet për konfigurimin e regjistrimit.

Opsionet e mëposhtme janë të disponueshme për rregullime:

**Zhvendosja maksimale në kohë:** Mund të caktoni një kufi kohor përfunksionin "Zhvendosja në kohë". Kufiri mund të caktohet nga 5 minuta deri në 1/5 orë me intervale të caktuara. Zhvendosja në kohë ndalon në përfundim të kufirit që keni caktuar.

**Lloji i regjistrimit:** Përcakton llojin e regjistrimit.

**Anullimi automatik**

**Anullo:** Fshin automatikisht regjistrimet sipas renditjes (më i gjatë, më i shkurtër, më i vjetër)

**Të palexuara:** Regjistrimet e palexuara mund "të përfshihen" ose "të përjashtohen". Mund ta zgjidhni me butonat "◀"/"▶".

**Pika kritike:** "Ju mund të bllokoni një kanal për një periudhë kohore sipas dëshirës suaj, për të penguar disa lloje programesh (me përmbajtje për të rritur, me gjuhë të papërshtatshme, etj.). Për të caktuar orën e 'njesjes', nënvizoni 'Nga' dhe caktoni orën e dëshiruar me anë të butonave "◀"/"▶". Për të caktuar orën e 'mbarimit', nënvizoni 'Deri në' dhe bëni të njëjtin veprim."

**Formato njësinë e diskut**

E RËNDËSISHME: Kini parasysh që të gjitha të dhënat në diskun USB do të humbasin dhe më pas formati i diskut do të konvertohet në FAT32 nëse aktivizoni këtë funksion.

- Nëse dëshironi të fshini të gjithë skedarët në njësinë e diskut USB ose kartën e memories, mund të përdorni opsionin **Formato diskun**.
- Po ashtu, nëse disku USB ka probleme, mund të provoni ta formatoni diskun USB. Në pjesën më të madhe të rasteve, formatimi i diskut USB do të rikthejë funksionimin normal - sidoqoftë TË GJITHA të dhënat e ruajtura në diskun USB do të humbasin në një rast të tillë.
- Shtypni butonin **OK** kur opsioni Formatato diskun është i nënvizuar. Në ekran do të shfaqet një meny që ju kërkon të futni një numër pin. Nëse nuk e keni ndryshuar numrin pin, numri i paracaktuar i fabrikës është 0000. Pasi të futni numrin pin, në ekran do të shfaqet një meny dritare për të



siguruar që disku duhet të formatohet; zgjidhni "Po" dhe shtypni **OK** për të formatuar diskun e ngurtë. Zgjidhni "JO" dhe shtypni **OK** për ta anuluar. Sigurohuni që të krijoni kopje rezervë të regjistrimeve të rëndësishme para se të formatoni njësinë e diskut USB.

**Informacioni i njësisë së diskut:** Për të parë detajet e diskut USB, nënvizoni Informacione të diskut të ngurtë duke përdorur butonin "▲" ose "▼" dhe shtypni OK. Informacionet e diskut USB do të shfaqen:

## Konfigurimi

Ju mund të konfiguroni përcaktimet e dekodert tuaj. Zgjidhni Konfigurimi nga menyja Parametrat dhe shtypni OK për të hyrë në këtë meny. Shtypni butonin DIL në telekomandë për të dalë.

Konfigurimi	
Vendi	Shqipëri
Rezultatet e konfigurimit	Zgjidh
Perditesimi i dekodert	v8.0 T9250
Kontrolli prinderor	Zgjidh
Vendosja e ores	Zgjidh
Fuqi e ulet	Po
Fikje automatike	Po
Kërkimi në gjendjen e gatishmërisë	Po

## Përcaktimet e rezultatit

Nënvizoni elementin me butonat "▲"/"▼" dhe shtypni butonin OK. Në ekran do të shfaqet një nënmeny:

**Lloji i televizorit:** Kanalet dixhitale tokësore mund të transmetojnë programe në një format të ekranit të gjerë që duhet të dalë ndryshe në aparatet televizive me ekran normal ose të gjerë. Theksoni linjën e Llojit të televizorit në menyën e Konfigurimit dhe përdorni butonat "◀"/"▶" për të zgjedhur "4:3" nëse keni një televizor standard të lidhur ose "16:9" nëse është një televizor me ekran të gjerë. Ky funksion dublikon zgjedhjen e bërë në momentin e instalimit fillestar dhe mund të përdoret nëse ndryshoni televizorët.

**Formati i ekranit:** Ky opsion nënvizohet me butonin "▲"/"▼". Formatit i ekranit mund të rregullohet si Pan&Scan, LetterBox 14:9 ose Letterbox 16:9 për televizorë 4:3 dhe Pillarbox ose Zoom (zmadhim) për televizorë 16:9 me anë të butonave "◀"/"▶".

**Modaliteti Scart.** RGB dhe CVBS janë të disponueshme.

**Preferenca e Dolby Digital:** Mund të zgjidhet po/jo.

**Dalja dixhitale audio:** LPCM dhe Dolby D janë të disponueshme.

**Antena aktive:** Përcaktimi, si i paracaktuar, është JOAKTIV. Nëse dëshironi të lidhni marrësin me një

antenë aktive si përforcues për sinjalin marrës, ju duhet ta ndryshoni Burimin e energjisë të antenës si AKTIV. Marrësi DVB-T mund të furnizojë 30 mA (dalja e antenës aktive 5V). Ju lutemi mos përdorni një antenë normale pasive (mos krijoni qark të shkurtër me lidhësin e hyrjes së antenës ANT IN) kur përcaktimi i Burimit të energjisë së antenës është AKTIV. Kjo gjë mund të shkaktojë një defekt në marrësin tuaj DVB-T.

**Dalja e televizorit:** Marrësi mund të japë sinjale RGB dhe CVBS nga SCART e televizorit në panelin prapa. Megjithatë formati RGB sjell një figurë me cilësi më të mirë, jo të gjitha pajisjet mund të përshtaten me sinjalin RGB.

**Rezolucioni HDMI:** Ky marrës mund të japë një rezultat në HDMI në 4 rezolucione të ndryshme: 576p, 720p, 1080i dhe 1080p nga lidhësi HDMI në panelin e pasmë. Për të marrë një figurë me cilësinë më të mirë të mundshme, ju lutemi kontrolloni rezolucionin HDMI të mbështetur nga televizori juaj dhe zgjidhni atë që është më i përshtatshëm nga kjo meny. Kini parasysh se vetëm kanalet e ruajtura mund të shikohen në HDMI, jo hyrja e VCR. Ky funksion dublikon zgjedhjen e bërë në momentin e instalimit për herë të parë.

**Vonesa eAudios:** Duke shtypur butonat "◀"/"▶" ose butonat numerikë, mund të caktoni Vonesën e audios në vlerën që dëshironi. Ky opsion është funksional vetëm për daljen e audios Spdif.

**Parametrat e audios:** Përdorni butonat "▲"/"▼" për të shkuar te opsioni Dalja e audios dixhitale. Përdorni butonat "◀"/"▶" për ta ndërruar mes PCM dhe E ngjeshur. Nëse zgjidhni E ngjeshur dhe zgjidhni një transmetim me Audion e ngjeshur, dalja e paracaktuar e audios do të jetë E Ngjeshur, por nëse zgjidhni PCM, dalja e audios do të jetë PCM Stereo. Kini parasysh se do t'ju duhet një përforcues i audios dixhitale me mbështetjen e audios së ngjeshur të lidhur te dalja dixhitale optike për të shijuar audion e ngjeshur.

**Energjia e ultë:** Nëse zgjidhni PO, do të aktivizohet modaliteti i energjisë së ulët. Në modalitetin e energjisë së ultë, konsumi i energjisë është më pak se 1 W (në gatishmëri). Ekranin e përparme nuk do të shfaqë informacionin e orës (në gatishmëri). Nëse çaktivizohet modaliteti i energjisë së ulët, të gjitha funksionet do të riaktivizohen.

**Fikja automatike:** Aparati do të kalojë automatikisht nga modaliteti aktiv në modalitetin në gatishmëri, pas më pak se tre orë në modalitetin aktiv në vijim të ndërveprimit të fundit të përdoruesit dhe/ose një ndryshimi të kanalit me një mesazh sinjalizues dy minuta para kalimit në modalitetin në gatishmëri. Fikja automatike është e vendosur si e paracaktuar dhe përdoruesi ka mundësinë ta ndryshojë Fikjen automatike si "aktive" ose "joaktive" në meny.

## Kërkimi në modalitetin në pritje

Ky opsion aktivizon ose çaktivizon veçorinë e skanimit automatik të kanaleve, i cili kryhet kur aparati është në modalitetin e gatishmërisë. Zgjidhni Po për ta caktuar si aktiv.

## Përmirësimi i marrësit

Sigurohuni që marrësi juaj dixhital ka gjithmonë softuerin e përditësuar. Vendoseni në modalitetin e gatishmërisë pasi ta përdorni. Marrësi do të ndizet automatikisht në orën 03:00 çdo ditë dhe do të kërkojë për çdo informacion të ri që mund të transmetohet dhe do t'i shkarkojë automatikisht në aparatin tuaj. Ky operacion do të zgjasë afërsisht 30 minuta. Nëse keni një regjistrim të rëndësishëm që duhet ta kryeni në 3 pd, i cili nuk duhet të ketë një ndërprerje prej 30 minutash, ju mund ta çaktivizoni kërkimin automatik të OAD duke vepruar si më poshtë:

1. Shtypni butonin e Menysë dhe më anë të butonave "◀"/"▶" theksoni KONFIGURIMI dhe shtypni butonin OK,
2. Përdorni butonat "▲"/"▼" për të theksuar "Përmirësimi i marrësit" dhe shtypni butonin OK.
3. Me anë të butonave "◀"/"▶" ndryshoni "Skanimi automatik" nga Aktivizuar në Çaktivizuar.
4. Përdorni butonin "▲"/"▼" për të theksuar "Skano për përmirësim" dhe shtypni OK.
5. Nëse ka një version të ri të softuerit, marrësi do të fillojë kërkimin.

Mos harroni të riaktivizoni funksionin OAD automatik pasi të keni kryer regjistrimin tuaj duke përsëritur udhëzimet e mësipërme.

SHËNIM: Nëse nuk ka softuer të ri për të shkarkuar, kjo procedure do të zgjasë vetëm rreth 20-30 sekonda. Nëse ka një softuer të ri të disponueshëm, kur ta ndizni aparatin tuaj nga statusi i gatishmërisë, në ekran do të shfaqet një mesazh konfirmimi për shkarkimin e softuerit të ri. Ne rekomandojmë që ta përditësoni aparatin tuaj.

## Kontrolli prindëror

Përdorni butonat "▲"/"▼" për të shkuar te opsioni "Kontrolli prindëror". Shtypni butonin OK për të hyrë në meny. Do të shfaqet një kuti që kërkon numrin e kyçjes. Kodi është vendosur fillimisht Shqip

në "0000". Futni kodin e kyçit. Nëse kodi është i gabuar, do të shfaqet "Pin i gabuar". Nëse është i saktë, do të shfaqet menja e Kontrollit prindëror:

## Klasifikimi i pjekurisë

Përdorni butonat "▲"/"▼" për të shkuar te opsioni Kyçi i pjekurisë. Përdorni butonat "◀"/"▶" për të ndërruar Modalitetin e Kyçit të pjekurisë. Kur aktivizohet, ky opsion merr informacione pjekurie nga transmetimi dhe nëse ky nivel pjekurie është i çaktivizuar, nuk shfaq video--audio.

## Kyçi i menysë

Mund të kyçni Të gjitha menyte ose Menyë në instalimit përtë kufizuar hyrjen në këto meny. Nëse kyçi i menysë është i çaktivizuar, hyrja në sistemin e menysë do të jetë e lirë. Përdorni butonat "▲"/"▼" për të shkuar te opsioni Kyçi i menysë dhe për të zgjedhur Modalitetin e kyçit të menysë.

**I çaktivizuar:** Të gjitha menyte janë të hapura.

**Të gjitha menyte:** Të gjitha menyte mund të hapen vetëm me butonin e saktë të kyçit. Kështu që përdoruesi nuk mund të shtojë, fshijë dhe riemërtojë kanalet, apo të përcaktojë kohëmatësit.

**Menja e instalimit:** Menja e instalimit është e kyçur. Kështu që përdoruesi nuk mund të shtojë kanale. Ndryshimet do të përditësohen pas mbylljes së "Menysë së konfigurimit".

## Vendosni PIN-in

Përdorni butonat "▲"/"▼" për të shkuar te opsioni "Vendos PIN". Shtypni OK përtëshfaqur dritaren "Vendos PIN". Përdorni butonat numerikë përtë futur një numër të ri pin (katër shifra). Ju do të duhet të futni pin-in e ri për herë të dytë për qëllime verifikimi. Në rast se të dy numrat pin janë njëllor, kodi pin do të ndryshohet. Numri pin i paracaktuar nga fabrika është 0000, nëse e ndryshoni numrin pin sigurohuni që ta shkruani dhe ta ruani.



## Përcaktimet e orës

Në menynë e konfigurimit, nënvizoni elementin Përcaktimet e ores duke shtypur butonat "▼" ose "▲". Shtypni OK dhe në ekran do të shfaqet nënmenyja Përcaktimet e ores. Ora aktuale, Zona orare dhe Parametrat e zones orare do të jenë të disponueshme.

Përdorni butonat "▼" ose "▲" për të theksuar Përcaktimet e zones orare. Përcaktimi Zona e orës vendoset duke përdorur butonat "◀" ose "▶". Mund të vendoset si "Auto" ose "Manual". Kur zgjidhni "Auto", opsionet e Zones orare nuk do të jenë të disponueshme për t'u ndryshuar. Nëse zgjidhni opsionin "Manual" si përcaktim të Zones së ores, Zona e ores mund të ndryshohet:

- Zgjidhni Zonën orare duke shtypur butonat "▲"/"▼". Përdorni butonat "◀"/"▶" për të ndryshuar Zonën e orës nga GMT-12 në GMT+12. Ora aktuale në krye të listës së menysë do të ndryshojë sipas Zonës së përzgjedhur të orës.

Përcaktimet e gjuhës

Në këtë meny përdoruesi mund të rregullojë gjuhën e preferuar. Gjuha ndryshohet duke shtypur butonin OK.

**Meny:** Tregon gjuhën e sistemit.

**Audio:** Ndryshon gjuhën e audios kur shtypet butoni "◀" ose "▶".

**Titrat:** Ndryshon gjuhën e titrave me butonat "◀" ose "▶". Gjuha e zgjedhur do të shfaqet te titrat.

**Guida:** Ndryshon gjuhën e guides kur shtypet butoni "◀" ose "▶".

## Preferuar

Këto përcaktime do të përdoren nëse janë të disponueshme. Në rast të kundërt do të përdoren përcaktimet aktuale.

## Parametrat aktuale

**Audio:** Nëse gjuha e audios është e mbështetur, mund ta ndryshoni duke shtypur butonin "◀" ose "▶".

**Titrat:** Nëse titrat janë të mbështetur, ndryshoni gjuhën e titrave me butonat "◀"/"▶". Gjuha e zgjedhur do të shfaqet te titrat.

## Formati i mbështetur i videos:


Mbajtësi i videos	Kodeku i videos	Kodeku i audios
AVI	XVID SD (MPEG4)	MP3, AC3, -MPEG-1

## MESAZHI I OSD-SË


Kur aparati nuk merr sinjal (p.sh. kabloja e antenës është e shkëputur), në ekran shfaqet mesazhi "NUK KA SINJAL".



Kur nuk ka asnjë kanal të ruajtur në aparat, nuk mund të hyni në Menynë e kohëmatësit dhe në Menynë e tabelës së kanaleve. Nuk lejohet navigimi nëpër kanale. Për këtë arsye, nëse provoni të hyni ose navigoni në këto meny, në ekran do të shfaqet një mesazh paralajmërues.



Kur nuk ka asnjë meny në ekran, mund të ndërroni Listat e preferencave me anë të butonit FAV. Nëse lista e preferencave është bosh, do të shfaqet mesazhi paralajmërues si më poshtë:



## Navigimi në kanale

**Kanale CH "▲"/"▼":** Nëse shtypni butonat CH "▲"/"▼", do të shkoni te kanali tjetër ose i mëparshëm në listë.

**Butonat numerikë:** Shtypja e një butoni numerik do të aktivizojë një dritare të futjes së një shifre të vogël në cepin lart majtas të ekranit. Pasi të futni një shifër, kutia do të presë për 2 sekonda që të fusni një shifër tjetër. Nëse në këto 2 sekonda nuk fusni një shifër tjetër, atëherë kutia do të kalojë te kanali i numrit të vendosur.

Nëse numri është më i madh se numri maksimal i kanaleve të futura, kutia do të kalojë automatikisht te kanali i fundit. Sa herë që kutia kalon te kanali i dëshiruar, në pjesën e poshtme të ekranit do të shfaqet një dritare informuese. Shiriti i vogël në anën lart djathtas të banerit tregon cilësinë aktuale të sinjalit.


Kur shtypni butonin INFO dhe kur ndërroni kanale, në pjesën e poshtme të ekranit shfaqet dritarja e informacionit. Shiriti i vogël tregon kohëzgjatjen e programit. Në dritaren e informacionit të kanalit ka:



- Emri i programit aktual, emri i programit pasardhës dhe oraret e tyre të "fillimit" dhe të "mbarimit".
- Shiriti i kohëzgjatjes së programit.
- Modaliteti i programit (televizor ose radio).
- Numri i kanalit.
- Emri i kanalit.

Në ekranin bosh, nëse shtypni butonat lart/ poshtë, do të shfaqet baneri i informacionit dhe ju do të mund të ndërroni mes kanaleve të ruajtura në listë. Për të pare një prej tyre, shtypni butonin OK.

Kur të kaloni te një kanal i kyçur, do të kërkohet kodi i kyçjes në një dritare që shfaqet në figure. Mund të hyni vetëm pasi të futni kodin e saktë. Për ta kapërcyer këtë kanal, përdorni butonat e kanaleve CH "▲"/"▼"



Kur shtypni butonat "VOL + / VOL -", do të shfaqet një baner. Ai tregon nivelin e volumit aktual në mënyrë grafike. Nëse i mbani të shtypur këta butona, mund të ngrini zërin me butonin "VOL +" ose ta ulni me "VOL -".



Kur shtypni butonin Bllokimi i zërit, simboli i bllokimit të zërit do të shfaqet në ekran. Ky simbol do të zhduket pas 3 ose 4 sekondash pasi të shtypni butonin BLOKIMI I ZËRIT. Simboli i bllokimit të zërit nuk shfaqet në ekran nëse ka ndonjë meny të hapur.




## Paraqitja e tekstit

- Shumë kanale dixhitale tokësore transmetojnë faqe informacioni për programet, motin, të rejtat, etj (disa kanale transmetojnë informacione të plota teleteksti). Mund të lëvizni nëpër kanalet e informacioneve duke përdorur butonat e navigimit ("▲"/"▼"/"◀"/"▶"), OK dhe butonat me ngjyra.
- Kur zgjidhni një kanal të tillë, ai zakonisht shfaq automatikisht faqen hyrëse të informacionit, pas një ndërprerje të shkurtër.

- Disa kanale kanë transmetime të faqeve të teletekstit dixhital bashkë me programin televiziv.
- Shtypni butonin TEKST për të aktivizuar faqet e teletekstit (nëse ka). Shtypni përsëri butonin TEKST për të dale.

Shënim: Në rast se se titrat janë aktivë, faqja e teletekstit nuk do të mund të shfaqet dhe do të shfaqet një shirit i vogël që tregon këtë gjë.



# TË DHËNAT TEKNIKE

## Të përgjithshme

Furnizimi me energji për dekoderin: 12V-220 AC/DC  
Frekuenca e hyrjes: 174MHz - 862 MHz Konsumi i energjisë: 10,8 W(maks) Dalja e antenës aktive: 5V - 50mA Temperatura e funksionimit: 5°C deri në +40°C Temperatura e magazinimit: -20°C deri në +70°C Lagështia: 25 deri në 75 % relative Përmasat fizike: 180 x 140 x 50 mm Peshë: 340 gr.  
Konsumi i ultë i energjisë në gatishmëri: Më pak ose i barabartë me 0,5 W

## USB (opsionale)

Nëse ka vetëm një USB  
Kufiri aktual: 500mA  
nëse të dyja USB-të janë të disponueshme  
Kufiri aktual:  
USB në anën e pasme: maks. 500mA  
USB në anën përpara: maks. 100 mA

## TELEKOMANDA

**Distanca e funksionimit:** 10m maks. Bateritë: 2x1.5 V (R-03/AAA)

## AFTËSITË DIXHITALE

**Standardet e transmetimit:** DVB-T, MPEG2  
DVB-T, MPEG4

### Demodulimi:

- **Shpejtësia e simbolit:** COFDM me modalitet 2K/8K FFT.
- **Modulimi:** 16-QAM - 64-QAM FEC përtë gjitha modalitetet DVB (të gjetura automatikisht)

### Video:

Dekoderi i videos MPEG-1/2/4  
Mbështet deshifrimin e videos ISO/IEC 13818-2  
MPEG-2 MP@HLderi në 1080p@30fps  
Mbështet deshifrimin e videos ISO/IEC 14496-2  
MPEG-4 SP dhe ASP deri në 1080p@30fps  
Mbështet formatin e videos FLV  
Dekoderi H.264  
Mbështet profilin kryesor dhe të lartë ITU-T H.264,  
ISO/IEC 14496-10 deri në nivelin 4.1 të deshifrimit të videos  
Mbështet rezolucionin deri në 1080p@30fps Y

### Audio:

- MPEG-1, MPEG-2 (Layer I/II), MP3, AC-3 (Dolby Digital), AAC-LC
- E-AC-3 (Dolby Digital Plus)
- Deshifrimi në shumë kanale 5.1 AAC, HE-AAC
- Mbështet njëkohësisht deshifrimin HE-AAC dhe transkodimin në AC-3
- Dalje transmetimi AC-3 nëpërmjet SPDIF
- Deshifrimi i audios stereo
- Deshifrimi RA8-LBR

### Lexuesi i medias


Skedarët e mbështetur: mp3, jpeg, avi, mkv  
Modalitetet e iluzionit: E disponueshme Modalitetet mbështeturatë leximit: Përsërit, përziej Rrotullimi i fotografisë: E disponueshme Mbështetja për etiketat MP3 ID3: E disponueshme  
Riliximi i skedarëve Mpeg4 dhe MKV: E disponueshme

## SCART NË TELEVIZOR

**Dalja e videos:** Sinjali i videos së përbërë:  
1 Vp-p=3dB/75 ohm

**Dalja audio:** 2 Vrms / Z = 10k ohm

**Ndryshimi i funksionit:** 12V / 6V for 4:3 / 16:9 / Z= 10k ohm



## ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

PROBLEMI	ARSYET E MUNDSHME	ÇFARË TË BËNI
Drita led e gatishmërisë nuk është e ndezur.	Kabloja elektrike nuk është e lidhur.	Kontrolloni nëse kabloja elektrike është e lidhur me prizën elektrike.
Nuk ka figure ose zë.	Nuk ka sinjal ose sinjal i dobët.	Kontrolloni kabllon e sinjalit dhe lidhjet scart.
Përcaktimet që keni vënë në meny nuk janë ndryshuar.	Dekoderi dixhital është hequr pa kaluar në pritje.	Para se të hiqni dekoderin dixhital, prisni që të kalojë në pritje.
	<ul style="list-style-type: none"> <li>· Dekoderi dixhital është në gatishmëri.</li> <li>· Telekomanda është drejtuar gabim.</li> <li>· Bateria e rënë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>· Shtypni butonin e gatishmërisë</li> <li>· Kontrolloni nëse ka ndonjë gjë që pengon panelin përpara.</li> <li>· Ndërroni bateritë.</li> </ul>
Keni harruar kodin e bllokimit të kanaleve.		Filloni instalimin për herë të parë. Më pas, kyçi do të hiqet.
Pasi ta kaloni marrësin në modalitetin në gatishmëri, kini parasysh se duhet të prisni 10 sekonda, para se ta ndizni përsëri.		
Videoja është në rregull për daljen HDMI, por audioja jo.	Linja HDMI është dëmtuar.	Shkëpusni dhe lidhni televizorin dhe dekoderin në të njëjtën kohë.
Mos përdorni një antenë normale pasive (mos krijoni qark të shkurtër të bashkuesit ANT IN) kur përcaktim i Burimit të energjisë së antenës është AKTIV. Kjo gjë mund të shkaktojë një defekt në marrësin tuaj DVB-T.		

## AL

### **Informacionet e mëposhtme janë vetëm për shtetet anëtare të BE-së:**

Përdorimi i simbolit tregon se ky produkt nuk mund të trajtohet si mbetje urbane. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju do të ndihmoni në shmangien e pasojave të mundshme negative për ambientin dhe shëndetin human, që mund të shkaktohen nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Për më shumë detaje rreth riciklimit të këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me autoritetet lokale vendore, shërbimin e grumbullimit të mbetjeve urbane ose dyqanin ku keni blerë këtë produkt



TRING TV SHA  
KOMPLEKSI DON BOSKO, KULLA7, KATI II, TIRANA  
NIPT: K61931005K ALBANIA



50269157